

Afrim KRASNIQI

Evoluimi i qëndrimeve të partive politike në Shqipëri ndaj rezistencës në Kosovë dhe ndikimi në to i ngjarjeve të vitit 1998

Në dhjetor 1990 në protestat studentore kundër sistemit komunist u dëgjua për herë të parë në 46 vjet thirrja “Kosova Republikë” dhe “Shqipëri - Kosovë”. Përgjatë regjimit komunist, Kosova ishte trajtuar në varësi nga raportet dhe interesat politike midis Tiranës dhe Beogradit. Për pjesën më të madhe të asaj periudhe Kosova konsiderohej një temë tabu. Në programet politike të Partisë së Punës së Shqipërisë - atë bazë më 1948 dhe ndryshimet që kanë pësuar gjatë 10 kongreseve të PPSH-së, nuk gjendet asnjë citim mbi Kosovën dhe problematikat që lidhen me të. Model inspirues ishte *“bashkëpunim i ngushtë me forcat e kampit demokratik antiimperialist, për një miqësi të sinqertë me Bashkimin Sovjetik, koka udhëheqëse e këtij kampi dhe me shtetet e demokracive popullore”*¹, një tregues domethënës për ideologjinë dhe tipologjinë e orientimit të shtetit shqiptar. Në praktikën e regjimit, në çdo legjislaturë parlamentare, kryeministrit parashtronte një program politik në Kuvendin Popullor. Analiza e këtyre raportimeve tregon se gjithashtu Kosova nuk ishte tematikë prioritare dhe se problematikat që lidheshin me shqiptarët në ish-Jugosllavi trajtoheshin në kuadër të prioriteteve ideologjike në politikën e jashtme. Midis 1944-1948 Shqipëria konsideronte prioritet absolut raportet ideologjike me Beogradin, midis 1948-1961 prioritet absolut

¹ Dokumente kryesore të PPSH-së, “Statuti i Partisë së Punës së Shqipërisë”, “NaimFrashëri”, 1971, Vëll. 1/2, f.521.

u bënë raportet ideologjike me Moskën dhe midis 1962-1975 prioritet absolut u bënë marrëdhëniet me Pekinin. Pas 1976, Shqipëria nuk pati më aleanca strategjike dhe zgjodhi vetizolim.

Në fillim të viteve '80, në gjendjen më të vështirësi politike dhe ekonomike të Shqipërisë komuniste, për herë të parë mediat zyrtare dhe institucionet zyrtare nisën të informojnë mbi Kosovën dhe zhvillimet atje. Ndryshimi i kursit reflekton ndryshimet në politikën e jashtme të Shqipërisë dhe faktin se zhvillimet intensive në Kosovë më 1981-1982 ishin në përputhje me trendin ideologjik të vetë regjimit në Tiranë. Për krahasim, kur në fundin e viteve '80 lindën lëvizjete reja politike dhe elitat e reja në Kosovë shprehën kritika për sistemet komuniste, përfshirë edhe atë në Shqipëri, informacioni për Kosovën iu nënshtroa censurës së plotë.

Teza kryesore e regjimit të Tiranës për refuzimin e pluralizmit politik dhe të procesit të liberalizimit gjatë viteve 1988-1990 ishte mungesa e përvojës dhe rreziku i madh ndaj identitetit dhe integritetit kombëtar. Pluralizmi konsiderohej kërcënim për pavarësinë dhe identitetin,² projekt perëndimor për shkatërrimin e kombit shqiptar dhe katalizator për konflikte politike e civile³. Teza antihistorike nuk kishte oponencë në Shqipërinë e viteve 1988-1989, por një zhvillim në Prishtinë ndikoi shumë në ndryshimin e sjelljes edhe në Tiranë. Kur elitat në Kosovë jetësuan pluralizmin politik dhe krijuan në dhjetor 1989 Lidhjen Demokratike të Kosovës, regjimi në Tiranë e humbi argumentin e tezës mbi pasojat e pluralizmit ndër shqiptarët. Identifikimi i lëvizjes shqiptare në Kosovë me LDK dhe partitë e reja

² Ramiz Alia, *Mbi thellimin e masave për revolucionarizimin e jetës së partisë dhe të gjithë vendit*, Vendim i Plenumit të 9-të të KQ të PPSH. ISML, shkurt 1990.

³ Ramiz Alia, *Demokratizimi në rrugën e Partisë*, ISML, Tiranë 1990, f.9.

që pasuan, ndikuan në mendimin politik të Tiranës,⁴ për të mbështetur tezën se përvoja pozitive e pluralizmit ndër shqiptarët e Kosovës mund të jetë funksionale edhe tek shqiptarët e Shqipërisë.

Në programin politik të Partisë Demokratike (1990), thuhej: *“Partia Demokratike njeh Republikën e Kosovës dhe kërkon respektimin e të gjitha të drejtave të popullit shqiptar që banojnë në trojet e veta në Jugosllavi, në radhë të parë, të drejtën e tyre për vetëvendosje”*⁵. Me termin “Republikë e Kosovës” PD i referohej aktit të Kuvendit të Kaçanikut, më 7 shtator 1990, kur delegatët miratuan Kushtetutën. Sipas nenit 1 të Kushtetutës *“Republika e Kosovës është shtet demokratik i kombit shqiptar dhe i pjesëtarëve të kombeve të tjera dhe i pakicave kombëtare...që jetojnë në Kosovë”*. Neni 3 përcaktonte se Republika e Kosovës është anëtare e Bashkësisë së Jugosllavisë. Referimi në Republikën e Kosovës përbënte një ndryshim thelbësor të sjelljes dhe qëndrimit të Tiranës politike ndaj Kosovës dhe perspektivës së saj. Në ligjërimin zyrtar të kohës termi dominues ishte *“të drejtat e shqiptarëve në Jugosllavi”*, ndaj ngritja në nivelin e njohjes së Republikës nga partia që përbënte alternativën e vetme për pushtet, ishte risi, zhvillim i rëndësishëm dhe tregues i fokusimit të opozitës demokratike në politika më kombëtare.

PD në program flet edhe për angazhim të saj *“për rritjen e dinjitetit politik, ekonomik dhe kulturor të kombit shqiptar në arenën ndërkombëtare”*, si dhe *“për një politikë të fqinjësisë së mirë e të paqes në rajon, mbi bazën e mbrojtjes së interesave kombëtare”*. Në vijim të

⁴ Elez Biberaj, *Shqipëria në tranzicion: Rruga e vështirë drejt demokracisë*, AIIS, Tiranë, 2011, f.67.

⁵ Afrim Krasniqi, “Partitë politike në Shqipëri 1912-2006”, *Rilindja*, Tiranë 2006, f.562.

programit politik të PD-së, theksohej se: *“për realizimin e aspiratave shekullore të kombit shqiptar, për liri, pavarësi, bashkim e përparim, në përputhje me frymën e dokumenteve të KSBE-së”*.⁶ Gjithashtu në këtë deklaram kemi elementë të rinj dhe të rëndësishëm, siç janë koncepti i *“aspiratës shekullore të kombit për bashkim”*. Lidhja midis kësaj aspirate me kriteret e përcaktuara nga KSBE (sot OSBE) shpreh ecjen paralele, nga partia me theks nacionalist e kombëtar, në parti moderne që pranon e respekton kriteret ndërkombëtare që lidhen me sovranitetin dhe kufijtë. Kjo del në pah edhe në përcaktimin e fundit programor se PD *“angazhohet për mospërdorimin e kërcënimit apo forcës kundër integritetit territorial ose pavarësisë politike të cilitdo shtet”*.⁷

Në të njëjtën kohë, në dhjetor 1990, partia e vetme në pushtet prej 1944, Partia e Punës së Shqipërisë, publikoi programin e parë politik në kushtet e pluralizmit politik. Programi ishte një bashkim i nocioneve ideologjike të partisë-shtet me ato të një partie konkurruese në sistemin e ri, kontrast që shprehet edhe në pjesën që lidhet për politikën e jashtme, ku bën pjesë Kosova. Sipas këtij programi⁸ *“ekzistojnë të gjitha mundësitë që vendet e Ballkanit t’i kapërcejnë grindjet dhe mëritë e vjetra dhe të rrojnë në paqe e miqësi midis tyre, të bashkëpunojnë për zhvillimin e vet e të përparojnë së toku, me vullnet të mirë dhe me durim.... Koha dhe përvoja e fituar na kanë bërë të vetëdijshëm se për përparimin e marrëdhënieve ndërballkanike duhen*

⁶Afrim Krasniqi, “Partitë politike në Shqipëri 1912-2006”, *Rilindja*, Tiranë 2006, f.563.

⁷Afrim Krasniqi, “Partitë Politike në Shqipëri 1912-2006”, *Rilindja*, Tiranë 2006, f.562.

⁸AQSH, Fondi 14, Dosja 32, Programi i PPSH-së për fushatën elektorale, 30.12.1990, f.13.

kapërcyer mjaft pengesa dhe duhen zgjidhur edhe disa probleme të komplikuar e specifike në rajonin tonë. Ndër to janë edhe problemet etnike të mbetura nga e kaluara. PPSH i përmbahet pikëpamjes se edhe të tilla çështje mund të rregullohen në qoftë se nisemi nga koncepte moderne, nga vizioni i Evropës së ardhshme, nga shikimi drejt kohëve që vijnë dhe jo prapa”. Duke iu referuar Kosovës PPSH deklaroi se “vija e drejtë politike e PPSH-së ka bërë që qëndrimi i mbajtur nga shteti ynë ndaj çështjes së Kosovës dhe të gjithë shqiptarëve në Jugosllavi, të jetë në përputhje me aspiratat kombëtare dhe kërkesat e drejta legjitime të gjithë popullit shqiptar dhe të vëllezërve tanë matanë kufirit. Partia jonë do të përkrahë e mbështesë si gjithnjë dhe pa asnjë lëkundje, kërkesat për të drejtat kombëtare e demokratike të shqiptarëve në Jugosllavi”.⁹Nëse në deklarin e parë ka teza utopike për ndarje me të kaluarën dhe kalimin e problemeve, pa përcaktuar specifika për përgjegjësitë, mekanizmat dhe veçoritë e pozitës së shqiptarëve në Jugosllavi, në deklarin e dytë legjitimon politikën e ndjekur nga PPSH-ja në raport me Kosovën dhe shqiptarët jashtë kufijve, duke e konsideruar atë qëndrim si maksimal dhe të gjithëpranuar. Në fjalinë e fundit ka një element të ri, ku PPSH angazhohet se do të mbështesë kërkesat për të drejtat kombëtare e demokratike të shqiptarëve në Jugosllavi - një referim për shqiptarët në Kosovë, në Maqedoni, në Malin e Zi apo në jugun e Serbisë. I gjithë paragrafi i PPSH-së që lidhet me Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, shfaq probleme të mosnjohjes së gjendjes, ikjes nga përgjegjësia dhe frikës për të rishikuar qëndrimet jashtë prizmit të një partie kryesisht internacionaliste.

⁹AQSH, Fondi 14, Programi politik i PPSH-së, dhjetor 1990, f.12.

Gjashtë muaj më vonë, në Kongresin e 10-të të PPSH-së dhe njëherësh kongresin themelues të PS-së, kjo parti bëri disa modifikime në programin e saj politik lidhur me Kosovën dhe çështjen kombëtare. Konkretisht, në pikën 5.8 të programit politik të PS 1991 theksohej se *“PS do t’i kushtojë kujdes të veçantë çështjes kombëtare. Në këtë kuadër ajo sheh problemin e Kosovës, të shqiptarëve që banojnë në trojet e veta në Jugosllavi, mbështet pa rezerva kërkesat e tyre të ligjshme e të pamohueshme për të siguruar liritë e të drejtat kombëtare në formën që ata e quajnë të pranueshme e të kohës. Partia jonë do të kujdeset dhe do të mbrojë interesat e Çamërisë, që është pjesë e pandarë e çështjes sonë kombëtare”*.¹⁰

Ndryshe nga dhjetori 1990, në qershor 1991, PS deklaroi se ajo *“është për një politikë të jashtme aktive në shërbim të interesave të kombit shqiptar, të përparimit të gjithanshëm të vendit dhe të integritetit të tij të natyrshëm dhedinjitoz në Evropën e Bashkuar”*.¹¹ Përfshirja e çështjesçame në formën e saj më të avancuar, përbën risi dhe një zhvillim serioz, që duhet kuptuar e shpjeguar në kontestin e kohës. Më 1991 në Greqi qeverisnin forcat konservatore, të cilat u bënë mbështetëse të rëndësishme të rotacionit të pushtetit politik në Shqipëri dhe për pasojë, krijuan pakënaqësi të mëdha tek PS dhe elita e vjetër komuniste. I njëjti shpjegim “hakmarrës” gjendet edhe tek faktori tjetër përëndimor, kryesisht SHBA dhe BE, kur në programin politik të PS theksohej se PS *“do të kundërshtojë dhe nuk do të pranojë ndërhyrjen e të huajve dhe arbitrazhin e tyre për të përcaktuar të vërtetën. Populli*

¹⁰Krasniqi, Afrim, “Partitë politike në Shqipëri 1912-2006”, *Rilindja*, Tiranë 2006, f.568.

¹¹Krasniqi, Afrim, “Partitë politike në Shqipëri 1912-2006”, *Rilindja*, Tiranë 2006, f.568.

shqiptar duhet të jetë zot në vendin e tij dhe problemet politike duhet t'i zgjidhë vetë me mendjen dhe vullnetin e tij" apo se PS "është për politikën e paqes dhe sigurimit kolektiv, kundër luftës në zgjidhjen e konflikteve ndërmjet vendeve të ndryshme, për mbrojtjen e lirisë dhe të drejtave të popujve, për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe fqinjësinë e mirë, për proceset e integritit e përkrahjen e organizmave ndërkombëtare... është e do të jetë për demokratizimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, që të dëgjohet e të merret në konsideratë zëri i të gjitha vendeve të mëdha e të vogla".¹²

Partitë e tjera politike nuk patën ndikim në vendimmarrjen politike, ndaj edhe programet e tyre nuk kanë rëndësi referuese. Me rëndësi është theksimi i faktit se pothuajse asnjë prej 11 subjekteve politike të zgjedhjeve të para pluraliste më 1991 nuk kishte identitet nacionalist dhe për rrjedhojë, nuk kërkonin bashkim kombëtar dhe as nuk denigronin shtetet fqinje, përfshirë Jugosllavinë e Greqinë. Nga analiza e ligjërimit politik rezultoi se në fillimet e pluralizmit elita politike e Tiranës nuk kishte njohuri të thelluara mbi problematikën në Kosovë në realitetet e reja gjeopolitike dhe mbi rrugëzgjdhjet e mundshme të saj, ashtu si edhe nuk kishin përvojë nëpolitikë dhe asnjë prej tyre nuk kishte hartuar politika.¹³ Ata kishin të drejtë në pranimin e konceptit se vetëm një shtet shqiptar demokratik dhe me orientim evropian, që respekton Kushtetutën, të drejtën dhe liritë individuale, mund të kishte forcën morale dhe kapacitetin të lobonte për Kosovën.¹⁴

¹²Afrim Krasniqi, "Partitë politike në Shqipëri 1912-2006", *Rilindja*, Tiranë 2006, f.569.

¹³Fred Abrahams, *Shqipëria e Re*, Tiranë, Dudaj, 2015, f.126.

¹⁴Mehmet Emerllahu, *Nyje shqiptare*, intervistë me SB, *Eurorilindja*, 2001, f.173-174.

Ritakimi i Shqipërisë me Kosovën

Më 1988-1991 Shqipëria ishte një prej shteteve më të dobëta dhe më të varfra në Evropë. Ndarja me regjimin e vjetër ishte kryesisht falimentim ekonomik i vendit. Brenda një viti kalendarik më shumë se 10% e qytetarëve emigruan në formën demonstrime dhe kolektive të ikjes, drejt Italisë, Greqisë dhe vendeve të tjera. Skenat e emigrimit masiv u bënë kryetuj në mediat perëndimore dhe u shoqëruan me habi, keqardhje dhe imazh kritik për shqiptarët në ritakimin e tyre me Evropën. Shteti shqiptar ishte i pafuqishëm për të ushtruar kompetencat e veta dhe vendi rrezikonte krizën e urisë.

Pikërisht në këto rrethana të jashtëzakonshme, regjimi në Tiranë e kompensoi humbjen e autoritetit të tij moral e qeverisës duke krijuar një agjendë të ligjërimit patriotik dhe nacionalist. PPSH dhe regjimi, pas 45 vjet heshtjeje apo refuzimi për një agjendë kombëtare në raport me Kosovën, në vitin e fundit të sundimit të tyre ndryshuan dukshëm qëndrimin. Pjesë e ligjërimit zyrtar të tyre u bë Kosova dhe gjendja e shqiptarëve në Jugosllavi. Raportimet mbi grevën e minatorëve në StariTërg në shkurt 1989, zunë vend qendror në edicionet zyrtare të lajmeve dhe se deklaratimet e grupimeve për të drejtat e njeriut u bënë pjesë e raportimit. Delegacione nga Kosova u pritën në takime nga zyrtarët më të lartë dhe vetë shteti mirëpriti përpjekjet simbolike të disa grupeve të vogla të propagandës apo të rezistencës për stërvitje apo asistencë nga Tirana.

Gjatë viteve të tranzicionit ka pasur intervista, deklarime dhe raporte mediatike, shpesh të përfshira edhe në studime të pjesshme në Tiranë e në Prishtinë, mbi fuqinë ushtarake të Shqipërisë në mesin e

viteve '80, planet e saj të fshehta ndaj Kosovës në rast konflikti aty, mbi kapacitetet për të fituar një luftë të mundshme me Jugosllavinë dhe mbi plane sekrete për të nxitur revoltën e trajnuar për ushtri sekrete në Kosovë. Të artikuluar nga ish-zyrtarë të lartë të regjimit dhe mbështetësit e tyre në Tiranë e Prishtinë, në arkivat shqiptare nuk gjendet asnjë provë serioze që të mund të provojë ekzistencën dhe për më tepër, vërtetësinë e tyre. Përkundrazi, në arkiva gjenden dokumente të shumta që tregojnë kontrollin e rreptë dhe dyshimin institucional ndaj çdo qytetari të Kosovës që emigronte ose vizitonte Shqipërinë, si dhe dënimin e rreptë të familjes së çdo qytetari të Shqipërisë që emigronte në Perëndim përmes kufijve me Kosovën.¹⁵ Po ashtu, raportet arkivore dëshmojnë se gjendja e ekonomisë shqiptare, e ingranazheve shtetërore dhe sidomos e ushtrisë shqiptare ishte pranë katastrofës. Vetëm në dy vitet e fundit, 1989-1990 ekzistojnë dokumente zyrtare në AQSH që provojnë se më shumë se 200 ushtarakë në shërbimet kufitare dezertuan dhe emigruan në vendet e tjera,¹⁶ një numër tjetër ushtarakësh e qytetarësh u ekzekutuan në përpjekje për të emigruar dhe se numri i vetëvrasjeve të reparteve ushtarake mori përmasa të mëdha.

Ilustrimi më i mirë i kompleksitetit të ritakimit midis Shqipërisë e Kosovës shprehet në sjelljen zyrtare të regjimit në Tiranë ndaj delegacioneve të larta të ardhura nga Prishtina, përfshirë figurën më të lartë përfaqësuese, Ibrahim Rugova, në atë kohë kryetar i LDK-së. Çdo delegacioni të Kosovës i kërkohet zyrtarisht të kryente nderime tek varri i diktatorit Enver Hoxha dhe i sugjerohej evitimi i çdo deklarimi

¹⁵AQSH, Fondi 14, Dosja 2, Relacion i ministrit të Brendshëm në Byronë Politike, 1990, f.4.

¹⁶AQSH, Fondi 14, Dosja 19, Mbledhje e Byrosë Politike, 04.12.1990, f. 14.

që lidhej me pluralizmin apo demokratizimin e jetës politike në Shqipëri. Kur Rugova erdhi në Tiranë, në shkurt 1991, rreth 60 ditë pas jetësimit të pluralizmit politik, pra në rrethana shumë më të favorshme sesa përpara dhjetorit 1990, ai u sulmua ashpër nga media zyrtare dhe mbledhjet e organeve më të larta të regjimit në Tiranë dhe në rrethe, për shkak se refuzoi të bënte homazhe nderimit tek varri i Enver Hoxhës. Gjithashtu, kur disa intelektualë të Kosovës iu bashkuan protestës studentore në dhjetor 1990 në Tiranë, apo grevës studentore të vitit 1991, apo kur njëri prej tyre, Z.Cana bëri kritika publike ndaj formës së realizimit socialist në letërsi, përsëri ndaj tyre pati sulme të ashpra dhe denigruese nga mediat e regjimit, përfshirë gazeta zyrtare e PPSH-së “Zëri i popullit”.¹⁷

Sistemi i ri politik dhe raportet e reja me Kosovën

Gjatë viteve 1992-1999 të gjitha partitë politike në Shqipëri bënë ndryshime në programet e tyre politike në raport edhe me Kosovën. Prioritet dhe vëmendje e madhe iu kushtua përputhjes së termave programore me pritshmërinë që kishte faktori ndërkombëtar, sidomos SHBA-ja, në raport me Kosovën. Nga angazhimet dhe deklaratimet për njohjen e Pavarësisë së Kosovës dhe për pasojë, trajtimin e Kosovës si shtet, u kalua në vlerësime që lidhen me mbështetjen e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe promovimin e çdo kërkesë që vetë kosovarët parashtronin në bisedimet ndërkombëtare. Kjo cilësi del në pah në analizën e ecurisë së tezave që ka promovuar qeveria shqiptare për rrugëzgjdhje finale të Kosovës - nga mbrojtja e të drejtave të njeriut, autonomia e plotë, pavarësia e kushtëzuar deri tek pavarësia e plotë.

¹⁷Afrim Krasniqi, Fundi i Siberisë shqiptare, Albin, 1998, f.186.

Dallimet midis qeverive të djathta dhe të majta në këtë drejtim janë minimale dhe kanë të bëjnë më shumë me ndjeshmërinë dhe përkushtimin personal të kryeministrave dhe të ministrave të jashtëm.

Në prizmin kohor 1991-1997 programet zyrtare të qeverive shqiptare të paraqitura në Parlament e kanë cituar vetëm një herë fjalën “Kosovë”, ndërkohë që në rastet e tjera kanë folur për shqiptarë në Jugosllavi apo në trojet jashtë kufirit shtetëror. Fokusi kryesor i të gjitha premtimeve të qeverive shqiptare kanë qenë vëmendja ndaj të drejtave të njeriut dhe të drejtës së shqiptarëve për vetëvendosje¹⁸Gjatë ushtrimit të mandateve ekzekutive secila qeveri ka ndjekur politika paralele nga programi “politikisht korrekt” në deklarime publike e takime ndërkombëtare, dhe mbështetëse me të gjitha mjetet në dispozicion në takimet direkt me liderët shqiptarë të Kosovës apo institucionet përfaqësuese të tyre. Edhe në këtë rast, e gjithë kurba e raporteve të shtetit shqiptar ndaj tendencave të reja në Kosovë (lëvizjes paqësore, protestave, luftës etj.) reflekton kurbën e raporteve shtetërore midis Shqipërisë dhe SHBA-së, të cilat prej vitit 1992 me vetëdije e kërkesë të vetë shtetit shqiptar kishin e vijnë në kenë ndikim thelbësor në qëndrimet e politikës së jashtme të Shqipërisë.

Në vijim janë parashtruar paragrafët që lidhen me Kosovën në programet zyrtare të secilës qeveri shqiptare midis viteve 1991-1998. Konkretisht:

- Kryeministri Nano në prezantimin e programit të qeverisë së tij, në maj 1991, në Parlament citon vetëm një herë Kosovën. Ai shprehet se në Jugosllavi “*ringjallja e nacionalizmit po rrezikon jo vetëm stabilitetin kombëtar, por edhe atë rajonal dhe evropian.*

¹⁸Mero Baze, Realitete shqiptaro-amerikane, *Koha*, 1997, f.127 dhe 132.

*Mbërthimi pas koncepteve nacionaliste, aq më tepër kërkimi i zgjidhjeve në kurriz të të tjerëve, e në këtë rast të shqiptarëve, nuk mund të jetë i efektshëm. Paqe dhe qetësi e vërtetë në Ballkan nuk mund të ketë në kurriz të fatit të shqiptarëve në Kosovë e Jugosllavi”.*¹⁹

- Kryeministri pasues Ylli Bufi dhe Qeveria e Stabilitetit, gjithashtu ka një citim për Kosovën në programin politik në Parlament. Sipas kryeministrit *“Qeveria do të kërkojë njohjen dhe respektimin e të gjitha të drejtave të vëllezërve tanë shqiptarë me banim në trojet e tyre në Jugosllavi, në përputhje me standardet ndërkombëtare, sikurse janë dokumentet e KSBE-së dhe Karta e OKB-së në frymën e rezolutës që ky Kuvend Popullor pluralist aprovoi me unanimitet të plotë për Kosovën”.*²⁰

- Kryeministri teknik Vilson Ahmeti (dhjetor 1991-prill 1992) gjithashtu citon vetëm një herë Kosovën në programin e tij politik në Parlament. Ai shprehet se *“ashtu si deri tani, edhe kjo Qeveri do të vazhdojë tëmbrojë interesat e popullsisë shqiptare jashtë kufijve tanë shtetërorë, veçanërisht, ajo do të kërkojë pranë shteteve, organizmave e institucioneve ndërkombëtare që të sigurohen të drejtat e ligjshme të popullit shqiptar në Kosovë e në Jugosllavi, sipas parimeve të KSBE-së. Ne jemi për një zgjidhje politike e paqësore të krizës jugosllave, në të cilën të merren parasysh interesat e popullsisë shqiptare, përfaqësuesit e të cilës duhet të jenë partnerë të barabartë në tryezat e bisedimeve”.*²¹

¹⁹Punime të Kuvendit, Legjislatura e 12-të, Viti 1991, Prezantimi i programit qeverisës, f.436.

²⁰Punime të Kuvendit, Legjislatura e 12-të, Viti 1991, Prezantimi i programit qeverisës, f.892.

²¹Punime të Kuvendit, Legjislatura e 12-të, Viti 1991, Prezantimi i programit qeverisës, f.2280.

• Më 1992 u bë rotacion politik dhe në pushtet erdhi Partia Demokratike. Qeveria Meksi (1992-1996) në programin e saj politik theksoi se *“Qeveria shqiptare do të ketë në qendër të vëmendjes veprimtarinë për zgjidhjen e problemit të shqiptarëve që banojnë në trojet e tyre në ish-Jugosllavi, duke u mbështetur në shembujt e krijuar deri tani nga qytetërimi evropian. Duke njohur Republikën e Kosovës dhe Qeverinë e saj të ligjshme, ne do të angazhohemi për zgjidhjen e kësaj çështjeje në rrugën e dialogut dhe të mjeteve paqësore në përputhje me parimin e vetëvendosjes”*.²² Më 1996 PD fitoi mandatin e dytë, dhe kryeministri Meksi ruajti postin. Në prezantimin e kabinetit dhe programit të ri politik, kryeministri deklaroi si synim *“vazhdimin e përpjekjeve për të trajtuar e mbrojtur me vendosmëri, koherencë dinjitet e aftësi, çështjen kombëtare shqiptare në Kosovë, Maqedoni ose në troje të tjera etnike shqiptare”*.²³

• Më 1997 një Qeveri e Pajtimit Kombëtar drejtoi vendin për disa muaj. Kabineti i drejtuar nga kryeministri Fino nuk kishte program qeverisës efektiv, por program emergjence ku vend kryesor zuri detyra *“t’u bëjë thirrje shteteve fqinje dhe shteteve të tjera të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës që të kontribuojnë me ndihma humanitare për mallrat ushqimore më të domosdoshme”*.²⁴ Për rrjedhojë, Kosova dhe gjendja aty ku nuk ishin pjesë prioritare e agjendës dhe as e angazhimit zyrtar. Në korrik 1997 Shqipëria jetësoi rotacionin politik dhe në Qeveri u rikthye PS me kryeministrin Fatos Nano. Në prezantimin e programit politik qeverisës Nano tha:

²² Punime të Kuvendit, Legjislatura e 13-të, Viti 1992, Prezantimi i programit qeverisës, f.86.

²³ Po aty, f. 333.

²⁴ Po aty, f.149.

*“mirëkuptimi ndaj të drejtave të ligjshme të shqiptarëve të Kosovës dhe realizimi i tyre do të përbënte një zhvillim cilësor pozitiv në marrëdhëniet midis dy vendeve tona (me Jugosllavinë, shënimi im), prej nga do të rridhnin përfitime rajonale. Qeveria e re shqiptare e konsideron problemin e shqiptarëve të Kosovës si një çështje mbarëkombëtare, zgjidhja e së cilës kërkon përpunimin dhe zbatimin e një politike të përbashkët po të përmasave mbarëkombëtare. Ajo do të përpiqet që të krijojë rrethana sa më të favorshme për realizimin e të drejtave të ligjshme të shqiptarëve në Kosovë në rrugë demokratike dhe në përputhje me aktet e njohura ndërkombëtare”.*²⁵Në përgjigjet e pyetjeve me deputetët, kryeministri premtoi se *“duhet të thërrasë një konferencë mbarëkombëtare për elaborimin e një programi, që do të shërbejë si orientim i politikës dhe diplomacisë sonë dhe si bosht i bashkërendimit të përpjekjeve të shqiptarëve kudo që janë. Ky do të ishte hapi i parë i Qeverisë në dobi të çështjes kombëtare”.*²⁶

Në tërësi, analiza e programeve qeveritare dhe e programeve partiake të dy dekadave të fundit rezulton se partitë kanë qenë më të avancuara në pikëpamjet dhe premtimet në momentin e fushatave elektorale, sesa të njëjtat parti në momentin e krijimit të qeverive. Partitë i janë adresuar votuesve, të cilët janë të prirur të dëgjojnë premtime konkrete dhe të avancuara, kurse qeveritë, në momentin e krijimit dhe gjatë ushtrimit të mandatit i adresohen institucioneve dhe partnerëve ndërkombëtarë, të cilët presin të shohin akte të moderuara politike dhe marrëdhënie të mira me të gjitha vendet e rajonit.

Duke krijuar sjellje të njëjta, duke bërë premtime të njëjta dhe duke ndjekur linjat përëndimore, ka ndodhur jo pak herë që partitë

²⁵ Po aty, f.585.

²⁶ Po aty, f.608.

shqiptare dhe për rrjedhojë edhe qeveritë e mazhoranca parlamentare, të humbasin origjinalitetin dhe të mos investohen në skema, projekte, strategji etj., që mund të çonin në kapërcimin e “vijës së kuqe” në linjën e “politikisht korrekt”. Për shembull, nëse Marrëveshja e Dejtonit la jashtë saj Kosovën, asnjë nga partitë politike në Shqipëri nuk pati në programet e saj elementë që lidhen me këtë marrëveshje, por secila indirekt theksoi nevojën që komuniteti ndërkombëtar të ofrojë një zgjidhje të qëndrueshme për Kosovën në kuadrin e zgjidhjes finale për Jugosllavinë e mbetur. Nëse Perëndimi mbështeti protestat e opozitës në Beograd të njëjtën gjë bënë edhe aktorët politikë në Tiranë, pavarësisht se nuk kishte dallime midis qeverisë e opozitës serbe për Kosovën. Më 1997 qeveria e majtë shqiptare mbështeti publikisht Millosheviqin në zgjedhjet përballë Sheshelit,²⁷ jo për shkak të simpatisë për të, por nga mungesa e vizionit strategjik dhe faktit se fitorja e një radikali ishte opsion i papranueshëm edhe për Perëndimin. Edhe kurba e njohjes së UÇK-së dhe kalimi nga cilësimi si organizatë “terroriste” deri tek nderimi më i lartë, reflekton kurbën që u ndoq nga SHBA-ja dhe aleatët e rëndësishëm perëndimorë. Nga ana tjetër, qeveritë shqiptare mbështetën me çdo mjet përfaqësitë politike të Kosovës në Perëndim, ndërmorën agjendën aktive sensibilimi të Perëndimit për Kosovën dhe bënë akte të shumta informale e jopublike për të asistuar lëvizjen paqësore²⁸ e më pas edhe lëvizjen e rezistencës në Kosovë.

²⁷Rexhep Meidani, Ne mbështetim Millosheviqin, cituar A.Shkullaku, “Koha Jonë”, 22.11.1997.

²⁸Mero Baze, Realitete shqiptaro-amerikane, *Koha*, 1997, f.139.

Tipare pozitive dhe kritike të bashkëpunimit

Gjatë tranzicionit ka elementë me rëndësi që vlen të theksohen, për shkak se vazhdimisht shkaktojnë debate dhe përdoren për interesa politike të ditës ose zhvillime që përbëjnë zhvillime me ndikim në perceptimin publik ndaj politikanëve e politikave të caktuara. Për shembull, me ndryshimet politike 1991-1992 disa grupe shqiptarësh të Kosovës u përfshinë në një program jozyrtar trajnimi dhe përgatitje nga njësitë ushtarake dhe të shërbimit sekret në Shqipëri. Programi ka vijuar për disa vite dhe pjesë e tij kanë qenë figura, të cilat më pas u bënë pjesë e rëndësishme e luftës çlirimtare në Kosovë. Burime të ndryshme zyrtare dhe mediatike kanë ofruar të dhëna për prezencën aktive në këtë program edhe të njeriut që më pas do të bëhet themeluesi dhe simboli i rezistencës në Kosovë, Adem Jashari. Përfshirja e shtetit shqiptar në këtë operacion trajnimi fillimisht ishte e asnjanshme, por më pas u dakordua me partnerët kryesorë ndërkombëtarë. Presioni perëndimor për kontrollin e çdo linje radikale, apo presioni politik brenda shqiptar (në Tiranë e në Kosovë) për të penguar që aktet e rezistencës të marrin ngjyrim ideologjik, çuan në kufizimin e programeve të ndryshme zyrtare dhe përqendrimin në agjenda të tjera asistence. Disa akte të rënda në Tiranë, përfshirë ekzekutive të politikanëve apo zyrtarë të lartë të përfshirë në luftë, janë reflektim i konfliktit midis agjendave dhe interesave politike në Tiranë dhe në Prishtinë.

Pas përfshirjes së Shqipërisë në programin “Partneritet për Paqe” dhe hapjes ndaj Perëndimit, disa prej qeverive perëndimore ushtruan presion ndaj Tiranës zyrtare për mbylljen e programit dhe inkurajimin

e një qëndrimi më tëmaturuar nga shqiptarët në Kosovë. Ata këshilluan Tiranën zyrtare të mbështesë presidentin Rugova në cilësinë e liderit politik të shqiptarëve dhe të inkurajojnë zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve midis Jugosllavisë së asaj periudhe dhe Kosovës. Tirana zyrtare iu përmbajt këshillës dhe presionit perëndimor, ndërkohë që marrëdhëniet midis Berishës e Rugovës si presidentë, midis Meksit e Bukoshit si kryeministra dhe midis PD e LDK si parti dominuese në dy vendet, ishin në kulmin e tyre. Ato u zhvilluan me intensitet të lartë, në komunikim të vazhdueshëm dhe në çdo aspekt të jetës dhe problematikave të dyanshme. Shqipëria zyrtare mori edhe masa të tjera zyrtare, për rritjen e nivelit të lobimit ndërkombëtar për Kosovën. Presidenti Rugova ishte në podiumin elektoral të PD-së në Shqipëri në mitingun e fundit përmbyllës të fushatës për Kushtetutën e Re në nëntor 1994 - një tregues i investimit dhe lidhjeve të forta dhe direkt, midis dy forcave politike, dy elitave politike dhe dy personaliteteve politike.

Kjo afri e dukshme dhe investim pa rezerva vijoi deri në fundin e vitit 1996, kur Shqipëria zyrtare u përfshi në krizë post-zgjedhore dhe kur Tirana zyrtare ushtroi presion publik ndaj elitës politike në Kosovë për të radikalizuar qëndrimet e saj.²⁹ Ndryshimi i kursit lidhej edhe me nevojën politike të Tiranës, në mesin e një krize të re politike. Aleatët perëndimorë e panë me shqetësim rritjen e toneve nacionaliste nga Tirana, konfliktin e stimuluar prej saj në elitën politike në Kosovë dhe avragimin e krizës politike në Tiranë, gjë që solli reduktimin e ndjeshëm të mbështetjes për presidentin dhe më pas mbështetjen e kërkesave për dorëheqjen e tij. Mosmarrëveshjet edhe personale midis Berishës e Rugovës çuan në ftohje të marrëdhënieve zyrtare dhe

²⁹ Mero Baze, Realitete shqiptaro-amerikane, *Koha*, 1997, f.149-150.

shkëputje të trendit bashkëpunues, të nisur më 1991. Nga ana tjetër, as rotacioni politik i vitit 1997 në Shqipëri dhe rikthimi i të majtës në pushtet nuk ndikoi në rikthimin e normalitetit në marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Kosovës. Për të majtët në Tiranë, Rugova dhe LDK-ja nuk ishin partnerë të besueshëm dhe anasjelltas. Takimi në Kretë midis kryeministrit Nano dhe presidentit Millosheviq më 1997, shkaktoi kritika publike të Prishtinës ndaj Tiranës zyrtare³⁰dhe se e gjithë periodha në vijim, përfshirë edhe Marrëveshjen e Rambujesë, krijoi dy vija paralele midis qëndrimeve dhe preferencave zyrtare të dy kryeqendrave shqiptare. Fillimisht qeveria e viteve 1997-1998 ndërmori sulme ndaj Rugovës dhe institucioneve të tij, por në mesin e vitit 1998, pas përshkallëzimit të situatës në Kosovë dhe nën këshillën ndërkombëtare, Tirana korrektoi qëndrimin. Kryeministri Nano në raportimin në Kuvend, më 31 mars 1998, deklaroi se: “*Qeveria shqiptare nuk ka synuar dhe as që synon të dublojë, të modifikojë apo të neutralizojë qëndrimet e autoriteteve të zgjedhura nga populli shqiptar i Kosovës*”.³¹

Prej vitit 1997 dhe deri më 2004, përfshirë edhe periudhën e luftës në Kosovë (1999) marrëdhëniet Tiranë-Prishtinë më shumë se marrëdhënie shtetërore funksionuan si marrëdhënie partiake e personale. Kabinetet e majta në Tiranë kërkuan e gjetën aleatë në forcat e reja politike të majta në Kosovë, duke ruajtur trendin kritik ndaj LDK-së e presidentit Rugova, kurse opozita e djathtë korrektoi qëndrimin duke tentuar lidhje të forta me të djathtët në Kosovë dhe duke u bërë kritike ndaj forcave të reja të dala nga lufta. Vetëm pas vitit

³⁰ Paskal Milo, Ditari i një ministri të Jashtëm, Konflikti i Kosovës 1997-2001, Toena, 2009, f.24.

³¹ Punime të Kuvendit, Legjislatura e 15-të, Viti 1996, f.595.

2004, kohë kur jeta politike në Tiranë e Prishtinë pësoi ndryshime të ndjeshme, situata u normalizua. Asnjëri prej liderëve politikë, Nano e Berisha në Shqipëri dhe Rugova e Thaçi në Kosovë, nuk kishin më aq shumë pushtet sa të diktonin zhvillimet në palën tjetër, ndaj edhe secili korrektoi qëndrimin e vet duke gjetur pika kontakti e fusha bashkëpunimi. Presidenti Rugova vizitoi Tiranën, rotacioni politik largoi Nanon nga politika, Thaçi u bë bashkëdrejtues koalicioni në Kosovë dhe Berisha pranoi humbjen e ndikimit të tij tek elita në Kosovë.

Situata e re politike shënoi fundin e më shumë se një dekade plot ulje e ngritje dhe fillimin e një bashkëpunimi më institucional e më gjithëpërfshirës midis qeverive, partive dhe institucioneve të secilit vend, shtetit të Shqipërisë dhe shtetit të Kosovës. Përjashtim pozitiv nga periudha e kontestimeve dhe uljengritjeve në raportet dypalëshe përbëjnë disa momente me rëndësi në zhvillimet reciproke: të gjitha partitë politike në Shqipëri mbështetën lëvizjen studentore në Kosovë më 1997 dhe 1998, të gjitha mbështetën rezistencën që simbolizoi Jashari dhe elita themeluese e UÇK-së, të gjitha palët mbështetën masat për asistimin e qindra mijëra kosovarëve të dëbuar me dhunë më 1998-1999, të gjitha palët mbështetën ndërhyrjen ndërkombëtare në Kosovë, zgjedhjet në Kosovë dhe zhvillimet e tjera më të rëndësishme atje. Po ashtu, të gjitha palët në Kosovë mbështetën nevojën për stabilitet e fund të konfliktit politik në Shqipërinë e vitit 1997, të gjitha mbështetën procesin integruar të Shqipërisë dhe çdo kompromis e marrëveshje të arritur midis ta djathtës e të majtës në Shqipëri. Kjo përvojë ka vlerë për të kuptuar se në interesat e mëdha, në momente decizive, në nevojat për stabilitet e integrim, elitat politike në Tiranë e Prishtinë kanë qenë e janë në unison.

Ngjarjet e marsit 1998 dhe ndikimi në Tiranë

Kur edicioni kryesor i lajmeve në TVSH dha informacion mbi masakrën në Drenicë dhe citoi vrasjen e Adem Jasharit, me emërtimin e themeluesit të UÇK-së, në Tiranën politike dhe publike impakti ishte i menjëhershëm. Media, grupet civile, organizata, institucione, universitete etj., u përfshinë në një valë reagimesh, protestash, informimi të partnerëve ndërkombëtarë etj., duke ndikuar sadopak në perceptimin brenda vetes dhe më pas edhe tek partnerët mbi realitetin e ri në Kosovë. Ka një detaj interesant që vlen të theksohet, publiku shqiptar në Tiranë ishte më i avancuar sesa elitat politike në mbështetjen e lëvizjes së rezistencës së armatosur në Kosovë, ndaj mbështetja publike për çdo komunikatë, deklaram etj., në emër të rezistencës mori mbështetje maksimale nga publiku. Presioni nga publiku dhe nevoja elektorale për mbështetjen e tyre ndikoi që edhe politikanët të ndryshojnë qëndrimet e tyre, dhe ta kalojnë nga retorikat e të drejtave të njeriut tek retorika më realiste.

Nga ana tjetër, emri i Adem Jasharit ishte tërësisht i panjohur për publikun dhe vetëm pas vrasjes së tij emri u bë pjesë e raportimeve në media, e aktiviteteve, protestave, reagimeve të ndryshme dhe deri tek aktivitetet sensibilizuese kulturore e patriotike. Emri i tij duket se ishte i panjohur edhe për liderët politikë të Tiranës dhe drejtuesit e institucioneve në vite, të cilët nëçdo deklaram të deritanishëm kanë lënë të kuptojnë se nuk kanë pasur njohje personale dhe as kontakte direkte apo indirekte. Ky faktor pati ndikim pozitiv, sepse asnjë palë politike në Tiranë nuk e lidhi emrin dhe aktin e tij me parti të caktuara politike, ideologji apo interesa elektorale, dhe për rrjedhojë, secila palë investoi

tek domethënie simbolike e rezistencës së tij mbi partitë, në funksion të interesit publik e kombëtar.

Marsi i vitit 1998 ndryshoi tërësisht qasjen e politikës në Tiranë dhe retorikës publike të saj. Kuvendi i Shqipërisë zhvilloi disa debate lidhur me gjendjen në Kosovë dhe miratoi dy rezoluta, një në mars dhe një në prill 1998, praktikë unike në historinë e tij 28-vjeçare. Në rezolutën e marsit, të bashkëhartuar nga kreu i Komisionit të Politikës së Jashtme, Sabri Godo dhe ministri i Jashtëm, Paskal Milo, thuhej se Kuvendi “shpreh shqetësimin dhe indignatën e thellë për operacionet ushtarake dhe gjenocidin e ushtruar në Drenicë dhe rajone të tjera të Kosovës, si rezultat i ndërhyrjes së forcave serbe dhe denoncon ashpër aktet barbare ndaj popullsisë së pambrojtur shqiptare të Kosovës, të cilat sollën mjaft viktime dhe të plagosur”.³² Kuvendi shprehu “solidaritetin mepopullin e Kosovës, me përpjekjet e tij për vetëvendosje dhe merr pjesë në dhimbjen emadhe për humbjen e jetëve të pafajshme, duke u gjetur në këto momente pranë shqiptarëve të Kosovës”.³³ Më tej Kuvendi apeloj bashkësinë ndërkombëtare “për domosdoshmërinë e shoqërimit të deklaratave për ngjarjet në Kosovë me iniciativa konkrete që do të vinin në lëvizje institucionet ndërkombëtare për praninë e tyre të menjëhershme në Kosovë dhe angazhimin konkret për ndalimin e konfliktit dhe parandalimine shtrirjes së mëtejshme të tij, si dhe gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme”.³⁴ Më 31 mars, Godo kërkoi në Parlament që Shqipëria të paraqesë kërkesën tek aleatët perëndimorë për “vendosjen e trupave të Kombeve të Bashkuara ose të NATO-s të jetë për brenda në Kosovë

³² Punime të Kuvendit, Legjislatura e 15-të, Viti 1996, f.363.

³³ Po aty, f.364.

³⁴ Po aty.

dhe jo në kufirin tonë e kjo duhet të bëhet një kërkesë më këmbëngulëse".³⁵Shumë më i tërhequr dhe siç tregoi koha, larg njohjeve mbi zhvillimet e pritshme, kryeministri Nano deklaroi në Parlament se është koha "*për t'u thënë serbëve dhe të gjithë popujve të tjerë që përbëjnë Jugosllavinë e mbetur se sot të jesh demokrat dhe i orientuar nga Evropa do të thotë të mos luftosh me armë për nostalgjira të mykura nacionale, por të konkurrosh dhe të bashkëjetosh për të shumëfishuar vlerat humane, për respekt reciprok të vlerave komplementare nacionale, për respekt të dinjiteteve kombëtare, për solidaritet njerëzor, për demokraci dhe prosperitet në tregje dhe në shoqëri të hapura, jo vetëm rajonale, por dhe globale*".³⁶

Partitë kryesore politike, rivale të ashpra ndaj njëra-tjetrës, kërkuar dhe gjetën pika takimi për të bashkëvepruar në nivel qendror dhe lokal. Bashki të opozitës dhe të mazhorancës, deputetë dhe institucione të tjera me përfaqësim pluralist bashkëvepruan me të gjitha mjetet në dispozicion për të asistuar rezistencën e re në Kosovë dhe më pas, prirjen e mijëra qytetarëve të Kosovës të dëbuar më 1998 dhe më pas më 1999. Palët politike organizuan në fillim të marsit 1998 mitingun e vetë pluralist në më shumë se dy dekada, "një komb - një qëndrim", kur oratorë ishin kundërshtarët e ashpër politikë, presidenti Rexhep Meidani, si dhe drejtuesit e dy partive të mëdha, Pandeli Majko në emër të PS dhe Berisha në emër të Partisë Demokratike. Të gjitha forcat politike, që nga komunistët ekstremistë të së majtës dhe deri tek forcat nacionaliste ekstreme të së djathtës, morën pjesë në manifestim dhe iu bashkuan nismës solidarizuese. Duket thënë se në këtë mënyrë

³⁵ Punime të Kuvendit, Legjislatura e 15-të, Viti 1996, f.592.

³⁶ Punime të Kuvendit, Legjislatura e 15-të, Viti 1996, f.595.

ngjarjet në Drenicë ndryshuan jo vetëm rrjedhën politike në Kosovë e në Serbi, por edhe në Tiranë.

Në vitet pasuese shteti shqiptar ka ruajtur unanimitetin në nderimin dhe vlerësimin e figurës së Adem Jasharit dhe rezistencës së armatosur në Kosovë, pavarësisë se partitë kryesore dhe qeveritë e tyre kanë pasur e kanë qasje preferenciale ndaj partive të ndryshme në Kosovë. Busti i Adem Jasharit u ndërtua në Tiranë nga qeveria e djathtë dhe u rindërtua më pas nga qeveria e majtë - këshilltarët e djathtë dhe të majtë kanë votën unanime në vlerësimin e tij pas vdekjes me tituj nderi në disa prej bashkive kryesore të Shqipërisë. Ngjarjet e vitit 1998 dhe emri i A.Jasharit është pjesë e teksteve shkollore, ka studime profesionale mbi këto zhvillime, ka nderime në emërimet rrugësh, ka prodhime në muzikë, art dhe kulturë. Presidentët e kryeministrat e ardhur nga e djathta apo e majta, kanë shprehur vlerësimet më të larta përmes vizitave dhe nderimeve ndaj Jasharit dhe trashëgimisë së tij politike. Zyrtarisht Adem Jashari mban dekoratën presidenciale më të lartë, “Urdhri i Flamurit Kombëtar”, me motivacionin “*Arkitekt dhe komandant i lëvizjes mbarëpopullore për çlirimin e Kosovës, i cili me shembullin e tij, deri në flijim, frymëzoi përpjekjet për liri e pavarësi të një populli të tërë*”.³⁷ Duhet theksuar se për shkak të ngarkesës politike shumë figura të tjera të Kosovës post ‘90 kanë pasur e kanë kontestime politike edhe në Tiranë, dhe anasjelltas në Prishtinë, por në rastin e themeluesit të UÇK-së ka pasur dhe ka konsensus të gjerë politik dhe publik.

³⁷ Dekret i Presidentit, 07.03.2013 (<http://president.al/old/presidenti-nishani-nderon-komandantin-e-uck-se-adem-jashari-pas-vdekjes-me-urdhrit-e-flamurit-kombetar-2/>)

Mësime e reflektime për të ardhmen

Brezi që jetoi vitet e '90 dhe ato përpara tyre, kanë pasur rastin të jetojnë realitete intensive në dy anët e kufirit. Shqipëria demokratike ishte një iluzion e aspiratë përpara vitit 1992, Kosova e pavarur ishte gjithashtu iluzion e aspiratë përpara vitit 1999. Miti fiktiv i Shqipërisë së fortë gjatë regjimit komunist i zuri vendin realpolitikës, ngritjes së vështirë të Shqipërisë nga imazhi i anijeve të mbushura me të rinj qëbraktisin vendin tek shteti anëtar në NATO e kandidat për në BE. Kosova gjithashtu kaloi sprovën të paimagjinueshme më parë - nga vendi i harruar në fundin e viteve '80 tek shteti më i ri properëndimor në Ballkan. Secili zhvillim e arritje daton në periudhë brenda më pak se tri dekadash, një periudhë intensive në zhvillime, në tipare dhe në kurbën e raporteve dhe të marrëdhënieve ndërshtetërore, ndërpolitike dhe ndërshtetërore.

Shqipëria u përpoq të luajë rolin e shtetit amë dhe e kreu këtë funksion sidomos në rastet e krizave të mëdha dhe ngjarjeve të jashtëzakonshme, siç ishte periudha e viteve 1998-1999, por në një masë tjetër të arsyeshme e luajti këtë rol edhe në periudhën e fillimit të tranzicionit me investimet në sensibilizimin ndërkombëtar të çështjes së Kosovës dhe në periudhën e Pavarësisë në lobimin për shtetin e ri të Kosovës. Midis këtyre periudhave, raportet dypalëshe shtetërore e politike kanë reflektuar tipare pozitive e kritike, por thelbi i tyre ka mbetur i qëndrueshëm.

20 vjet pas ngjarjeve në Kosovë dhe krimit shtetëror serb ndaj familjes Jashari, Kosova ka ndryshuar shumë, realiteti është tjetër dhe rrethanat e reja mundësojnë një qasje të re dhe shumë më profesionale

mbi ngjarjet, individët, korrelacionet me kancelaritë perëndimore, rolin e shtetit shqiptar, sukseset dhe dështimet e procesit të ecjes drejt lirisë së Kosovës. Përvjetorët janë edhe ftesë për reflektime, pasi ende ka elementë të pakonsumuar në analizë dhe në vlerësim. Realiteti i ri dhe potencialet shtetërore e shkencore në dy vendet ndeshen me sfidat për t'u dhënë përgjigjen profesionale zhvillimeve dhe çdo dileme rreth tyre.

Në këtë drejtim ka shumë ende për të bërë. Për shembull, ende arkivat shqiptare vijojnë të jenë të pahapura, ende në shkollat shqiptare nuk ka informacion të mjaftueshëm mbi Kosovën dhe rrugëtimin e saj drejt çlirimit dhe pavarësisë, ende nuk ka konsensus rreth tezës se pa qëndresën paqësore nuk do të kishte sensibilizimin e duhur drejt shtetit të ri ashtu siç edhe pa rezistencën nuk do të arrihej ndarje me Serbinë, ende trajtimi historik rend drejt individëve e ngjarjeve pa ofruar një skenë më të gjerë dhe më të plotë të të gjitha rrethanave dhe faktorëve, dhe se ende institucionet shtetërore dhe akademike nuk kanë një sistem funksional pune e koordinimi të atillë, saqë të krijojë memorien e duhur historike dhe ta trajtojë atë me profesionalizmin e duhur. Hapja e arkivave shqiptare të tranzicionit dhe mbledhja e dokumentacionit nga arkivat e vendeve të tjera të përfshira në ngjarjet në Shqipëri e Kosovë, do të ishte moment i rëndësishëm matjeje dhe vlerësimi të shumë prej ngjarjeve, personazheve, gjetjeve dhe tezave të deritanishme, duke i dhënë atyre dimensionin profesional në kohë e hapësirë, larg nga mitet apo paragjykimet mbi interesa afatshkurtra të tranzicionit.

